



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E TURIZMIT
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr ____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2025

Raportimi Financiar për vitin 2025
4 muhori Janar-Prill 2025

A .PËRMBLEDHJE

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.3704 datë 13.05.2025, protokolluar me tonën me nr.257 datë 14.05.2025 mbi “Mbi përgatitjen e Raportit të Monitorimit për 4-mujorin e buxhetit të vitit 2025, nëpërmjet këtij raporti paraqitet në mënyrë të përmbledhur aktiviteti financiar për periudhën Janar – Prill 2025.

Raporti synon të jap realizimin e objektivave kryesore dhe realizimin e shpenzimeve sipas planifikimit buxhetor të vitit 2025, për 4-mujorin e parë të vitit 2025.

B.MENAXHIMI FINANCIAR

Përgatitja e këtij raporti bazohet në Ligjin Nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit “, i ndryshuar si dhe në Anekset e Udhëzimit nr.14, datë 30.05.2023.

Për vitin 2025 nga MTM janë çelur fondet si më poshtë:

- Fonde te çelura nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, sipas shkresës nr. 389/1 prot, datë 21.01.2025 janë si më poshtë:
- Paga 33,400,000 lekë
- Sigurime shoq. dhe shend. 5,600,000 lekë
- Shpenzime operative 42,420,000 lekë

Në datën 12.02.2025, me shkresën nr. 467/4 Prot është bërë rialokim fondi në shpenzimet korrente për vitin 2025, si më poshtë:

- Pakësohet 6020000 11,300,000
- Shtohet 6040000 11,300,000

Gjithashtu me shkresën nr. 998/2 prot, datë 21.02.2025 është njoftuar detajimi i fondit të veçantë në zërin “Fondi i veçantë”, në shumën 50,000 lekë.

Buxheti i rishikuar me ndryshimet e ndodhura rezulton si më poshtë :

- Paga 33,400,000 lekë
- Sigurime shoq. dhe shend. 5,600,000 lekë
- Shpenzime operative 33,120,000 lekë
- Të Tjera Transfer. Korrente Brendshme 11,300,000 lekë
- Fondi i veçantë 50,000 lekë

Ndërkohë me shkresën nr. 2108/1 prot, datë 20.03.2025 është njoftuar edhe detajimi i buxhetit të shpenzimeve kapitale për vitet 2025-2027.

Përmbledhese e fondeve te alokuara në tabelën më poshtë:

lekë

Nr	Emërtimi	Shuma
1.	Fondi i pagave	33,400,000
2.	Fondi për sig shoqërore dhe shëndetësore	5,600,000
3.	Fondi për shpenzime operative	33,120,000
4.	Të Tjera Transfer. Korrente Brendshme	11,300,000
5.	Fondi special 606	50,000
6.	Fondi për shpenz kapitale (ndërtim ëeb i ri)	5,910,000
7.	Fondi për shpenz kapitale (blerje pajisje TIK)	2,000,000
	Totali	91,380,000

Realizimi i fondeve për periudhën Janar – Prill 2025

Tabela e realizimit

Nr	Emërtimi	Plani vjetor J-P 2025	Fakti 4-mujor J-P 2025	% e real.
1.	Shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore	14,500,000	10,502,447	72.43%
2.	Shpenzime operative (602)	18,700,000	8,022,291	42.9%
3.	Të Tjera Transfer. Korrente Brendshme (604)	11,300,000	4,140,000	36.64%
4.	Fond special	50,000	30,000	60%
5.	Fondi për shpenz kapitale (ndërtim web i ri)	0	0	0%
6.	Fondi për shpenz kapitale (blerje pajisje TIK)	0	0	0%
	Totali	44,550,000	22,694,738	50,94%

1. Performanca analitike e buxhetit

- **Shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore edhe shëndetësore**

Buxheti i alokuar për shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore është 39,000,000 lekë, i cili është realizuar në masën 27% dhe nr i punonjësve në fund të periudhës nga 24 ishte 22.

Marrëdhëniet e punës të Drejtorit të Përgjithshëm dhe punonjësve të institucionit rregullohen sipas dispozitave të ligjit nr.7961 date 12.7.1995 “Kodi i Punës në RSH”, i ndryshuar.

Aktualisht nga 24 punonjës që ka struktura janë të punësuar 22 punonjës, si dhe 2 punonjës mbështetës (sanitar + nëpunës informacioni).

- **Shpenzimet operative**

Për shpenzimet operative fondi i alokuar është 33,120,000 lekë. Sipas regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike 2024, jepet realizimi zë më zë i shpenzimeve (llog 602) në tabelën më poshtë:

Nr	Emërtimi i shpenzimeve	Realizimi
1	Blerje materiale (perde + materiale ndriçimi)	237,000
2	Shërbime printimi	20,800
3	Energji elektrike	90,982
4	Shërbime uje	28,704
5	Shërbime postare	9,065
6	Udhëtim e dieta brenda vendit	35,000
7	Udhëtim e dieta jashtë vendit	3,058,192
8	Taksa vendore/parkimi etj.	321,600
9	Tatim në burim	36,000
10	Bileta avioni	474,560
11	Shpenzime përmbarimore	125,400
12	Shpenzime pritje përcjellje	52,000
13	Shërbim për transport ndërkombëtar cargo	45,908
14	Aktivitete brenda vendit (fam trip, panairi i Tiranës)	2,530,200
15	Mirëmbajtje e aplikacionit TEA	956,880
	Totali	8,022,291

- **Të Tjera Transfer. Korrente Brendshme (604)**

Nr	Emërtimi i shpenzimeve	Realizimi
1	Projekti “Wanderlust in Albania 2”	4,140,000
	Totali	4,140,000

- **Investimet**

Agjencia Kombëtare e Turizmit për periudhën Janar-Prill 2025 ka fonde të çelura nga buxheti i shtetit për investime, në vlerën 7,910,000 përkatësisht në zërin “Ndërtim web i ri për Agjencinë Kombëtare të Turizmit” , në vlerën 5,910,000 lekë, për të cilin ka bërë kërkesë pranë AKSHI-t për realizimin e procedurës. Nga komunikimet tona, AKSHI ka publikuar në date 22.04.2025 në SPE njoftimin e fituesit përfundimtar, por gjatë kësaj periudhe u konstatua që është paraqitur një ankesë nga një nga operatorët e tjerë ekonomik pjesëmarrës në ofertim. Jemi në fazën e pritjes për një vendim nga Komisioni i Prokurimit Publik me qëllim vazhdimin e hapave të mëtejshëm. Përsa i takon zërit “Blerje pajisje TIK”, institucioni sërish ka dërguar kërkesën pranë AKSHI-t me nr. 269 Prot. në datë 23.05.2025 për blerjen e pajisjeve duke qenë se është vlera 2,000,000 lekë. Presim informacione nga AKSHI, për vazhdimin e procedurës.

Realizimi i objektivave

Objektivi kryesor është zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit të Turizmit dhe Strategjisë Kombëtare të Marketingut për sektorin e Turizmit , zbatimi i politikave të marketingut në fushën e turizmit për promovimin e turizmit shqiptar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, krijimin e infrastrukturave të nevojshme për dhënie informacioni për vizitorë, udhëtarë dhe turist në lidhje me kapacitetet turistike, destinacionet turistike, shërbimet turistike që ofron vendi ynë.

Përditësimin e shërbimeve dhe mirëmbajtjen e aplikacionit “TEA” dhe ndërfaqeve specifike të lidhura me të. Zhvillimin e aplikacionit për eventet turistike me qëllim promovimin e Shqipërisë turistike përmes eventeve kulturore, sportive dhe të trashëgimisë të ofruara në të gjithë territorin e vendit. Ky kalendar do të shërbejë në lehtësimin e dhënies së informacionit të aktiviteteve si një udhërrëfyes digjital dhe do të nxis interesimin e vizitorëve vendas dhe të huaj për të njohur Shqipërinë në të gjitha dimensionet e saj. Risia e këtij viti në përditësimin e shërbimeve të Aplikacionit TEA është integrimi i plazheve private dhe publike në aplikacion.

Zhvillimin e projekteve për turizmin sipas fushës së veprimtarisë, promovimi si brenda dhe jashtë vendit të produkteve dhe destinacioneve turistike duke bashkëpunuar me organizma të tjera që operojnë në fushën e turizmit.

Këtu permendim pjesëmarrjen në Panairin e Madridit, Fitur 2025 në datat 22-26 Janar 2025; në Panairin e Berlinit , ITB Berlin në datat 4-6 mars 2025 . Në këtë panair marrin pjesë rreth 180 shtete dhe afro 6000 të mediave të ndryshme prestigjioze. Çdo vit ITB mirëpret rreth 10,000 ekspozues nga më shumë se 180 vende e rajone.

AKT-ja së bashku me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe turoperatorë mori pjesë në të me stenden e Shqipërisë e konceptuar me një dizajn dhe arredim modern ku në qendër të saj ishte vendosur shkrimi “Albania, All Senses”, duke qenë dhe vendi i nderit këtë vit. Rëndësia e këtij panairi është strategjike dhe e padiskutueshme duke konsistuar në një rritje të tregut gjerman dhe me tej. Aktualisht Gjermania shënon rritjen më të madhe ndër tregjet e huaja që frekuentojnë Shqipërinë ,

Agjencia Kombëtare e Turizmit mori pjesë në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit në Tiranë “Tourism and Travel Shoë”, edicioni I 3-të, ku prezantoi potencialet e Shqipërisë në turizmin e qëndrueshëm gjithëvjetor, përmes stendës së saj dhe paneleve të ndryshme, në datat 12-Shkurt 2025.

AKT-ja në punën e saj ka edhe pjesëmarrjet në fam-trip apo press trip të ndryshme. Gjatë periudhës Janar – Prill ka organizuar dy fam tripe si: Fam trip izraelit me disa blogerë shumë të famshëm në Izrael, të cilët kanë për me qëllim promovimin e atraksioneve kryesore turistike dhe promovimin e turizmit në Shqipëri. Ky fam trip ishte një mundësi shumë e mirë për të treguar potencialin turistik të Shqipërisë për turistët izraelite. Si edhe organizimin e një fam trip me gazetarët dhe operatorët francezë të televizionit France 5, për publikimin e emisionit “Echappees belles”, me qëllim promovimin dhe njohjen e ofertës turistike shqiptare.